# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2022 – Numri: 145

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E mërkurë, 2 nëntor 2022**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 26.10.2022 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së ndotësve organikë të qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre"........................ | 17725 |
| Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 22.6.2022 | Për miratimin e procedurave të bashkëpunimit ndërinstitucional për përcaktimin e kuotave vjetore për punësim.......................................... | 17737 |
| Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 19, datë 22.6.2022 | Për deklarimin për punësim...................................................................... | 17738 |
| Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 178, datë 22.6.2022 | Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për Plotësimin e Kushteve të Lejes Unike si Investitor....................... | 17739 |
| Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 180, datë 22.6.2022 | Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Komisionit Vlerësues për Plotësimin e Kushteve të Lejes Unike si i Vetëpunësuar............... | 17740 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 479, datë 24.10.2022 | Për shfuqizimin e urdhrit nr. 249, datë 11.6.2021, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës dhe Italisë"...... | 17741 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 480, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Rumanisë. | 17742 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 481, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Republikën e Çekisë.......................................................................................... | 17743 |

| | | |
|---|---|---|
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 482, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Francës..... | 17743 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 483, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës... | 17745 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 484, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë........................................................................................... | 17745 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 485, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë. | 17747 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 486, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.. | 17747 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 487, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Kroacisë... | 17748 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 488, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Moldavisë | 17749 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 489, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë.. | 17750 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 490, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... | 17751 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 491, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Portugalisë.......................................................................................... | 17751 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 492, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.... | 17752 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 493, datë 24.10.2022 | Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë........ | 17754 |
| Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 29, datë 27.10.2022 | Për përcaktimin e programeve të formimit profesional që përfitojnë nga mbështetja financiare, për vitin 2022................................................ | 17756 |

**VENDIM**
**Nr. 691, datë 26.10.2022**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 360, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË NDOTËSVE ORGANIKË TË QËNDRUESHËM DHE PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR PRODHIMIN, IMPORTIMIN, VENDOSJEN NË TREG DHE PËRDORIMIN E TYRE"[1]**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 30, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 360, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 4, të kreut I, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1.1 Shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" ndryshohen, si më poshtë vijon:

"a) **"Vendosje në treg"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve.

b) **"Artikull"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

c) **"Përzierje"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

ç). **"Stok"** janë substancat, përzierjet ose artikujt e grumbulluar nga mbajtësi i stokut që përbëhen ose përmbajnë ndonjë prej substancave të renditura në aneksin I, bashkëlidhur këtij vendimi.".

1.2. Pas shkronjës "ë", të pikës 4, shtohen shkronjat "f", "g", "gj", "h", "i", "j", me këtë përmbajtje:

"f) **"Import"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve.

g) **"Prodhim"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

gj) **"Përdorim"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

h) **"Substancë"** ka të njëjtin kuptim me termin e përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve".

i) **"Substancë e ndërmjetme në sisteme të mbyllura me sipërfaqe të kufizuar"** është një substancë që prodhohet, konsumohet ose përdoret për përpunim kimik për t'u transformuar në një substancë tjetër ("sintezë"), ku prodhimi i substancës së ndërmjetme dhe sinteza e një ose më shumë substancave nga ajo substancë e ndërmjetme ndodh në të njëjtin vend, nga një ose më shumë subjekte, në kushte rreptësisht të kontrolluara, në mënyrë që të përmbahet në mënyrë rigoroze me mjete teknike gjatë të gjithë ciklit të jetës".

j) **"Ndotës gjurmë i paqëllimshëm"** është niveli i një substance që gjendet rastësisht i pranishëm në një sasi minimale, e cila nëse gjendet nën këtë sasi minimale nuk mund të përdoret në mënyrë kuptimplotë dhe mbi limitet e gjurmimit të metodave ekzistuese të gjurmimit që mundësojnë kontrollin dhe zbatimin.".

2. Anekset I, II, III dhe IV, të përcaktuara në shkronjat "a", "b", "c" e "ç", të pikës 3, të kreut I, zëvendësohen me anekset I, II, III dhe IV, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Kudo në përmbajtjen e vendimit, emërtimi "Ministria e Mjedisit" zëvendësohet me fjalët "...ministria përgjegjëse për mjedisin...", si dhe emërtimi "Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve" zëvendësohet me fjalët "...struktura përgjegjëse për kontrollin dhe inspektimin në fushën e mjedisit...".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 dhjetor 2022.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

[1] Ky vendim përafron pjesërisht Rregulloren (EU) 2019/1021, të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian, të datës 20 qershor 2019, mbi ndotësit organikë të qëndrueshëm *(recast)*, OJ L 169 25.6.2019, f. 45; CELEX: 02019R1021, të ndryshuar.

ANEKSI I

PJESA A
SUBSTANCAT E LISTUARA NË KONVENTË DHE NË PROTOKOLL, SI DHE SUBSTANCAT E LISTUARA VETËM NË KONVENTË

| Nr. rendor | Emri i substancës | Nr. CAS | Kodi tarifor sipas NK së mallrave | Nr. KE | Përjashtime specifike për përdorim të ndërmjetëm ose specifikime të tjera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Eteri i Tetrabromodifenilit *(Tetrabromodiphenyl ether)* $C_{12}H_6Br_4O$ | 40088-47-9 dhe të tjera | 2909 30 38 | 254-787-2 dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e eterit të tetrabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur është i pranishëm në substanca.<br>2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe dekabromodifenil, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose artikuj.<br>3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat përmbajnë eter tetrabromodifenili në përbërje. |
| 2 | Eteri i Pentabromodifenilit (*Pentabromodiphenyl ether)* $C_{12}H_5Br_5O$ | 32534-81-9 dhe të tjera | 2909 30 31 | 251-084-2 dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e eterit të pentabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur ndodhet në substanca.<br>2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe dekabromodifenil, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose artikuj.<br>3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter pentabromodifenili në përbërje. |
| 3 | Eteri i Hekzabromodifenilit *(Hexabromodiphenyl ether)* $C_{12}H_4Br_6O$ | 36483-60-0 dhe të tjera | 2909 30 38 | 253-058-6 dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e eterit të hekzabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001% të peshës), kur është i pranishëm në substanca.<br>2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj.<br>3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter hekzabromodifenili në përbërje. |
| 4 | Eteri i Heptabromodifenilit (*Heptabromodiphenyl ether)* $C_{12}H_3Br_7O$ | 68928-80-3 dhe të tjera | 2909 30 38 | 273-031-2 dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e eterit të heptabromodifenilit, që është i barabartë me ose nën 10 mg/kg (0,001% të peshës), kur ndodhet në substanca.<br>2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj.<br>3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë eter heptabromodifenili në përbërje. |
| 5 | Eter bis(pentabromofenili) eter (dekabromodifenili; decaBDE) (*Bis(pentabromophenyl) ether (decabromodiphenyl ether; decaBDE))* | 1163-19-5 | 2909 30 38 | 214-604-9 | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e decaBDE, që janë të barabarta me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur ndodhet në substanca.<br>2. Për qëllime të hyrjes së substancave tetra-, penta-, hekza-, hepta- dhe decaBDE, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për masën e përqendrimit të këtyre substancave deri në |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 500 mg/kg, që ndodhen në përzierje ose në artikuj;<br>3. Si përjashtim, lejohet prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i decaBDE për qëllimet e mëposhtme dhe në përputhje me parashikimet e Konventës:<br>a) në prodhimin e një mjeti ajror, për të cilin miratimi i tipit është kërkuar përpara datës 2 mars 2019 dhe është marrë përpara dhjetorit të vitit 2022, deri më 18 dhjetor 2023 ose, në rastet kur arsyetohet nevoja për shtyrje, deri më 2 mars 2027;<br>b) në prodhimin e pjesëve të këmbimit për:<br>i. një mjet ajror, për të cilin miratimi i tipit është kërkuar përpara datës 2 mars 2019 dhe është marrë përpara dhjetorit të vitit 2022, prodhuar përpara datës 18 dhjetor 2023 ose, në rastet kur arsyetohet nevoja për shtyrje, prodhuar përpara datës 2 mars 2027, deri në përfundim të kohëzgjatjes së shërbimit të atij mjeti ajror;<br>ii) mjete motorike që janë objekt i udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 11, datë 30.5.2011, "Për miratimin e mjeteve motorike dhe rimorkiot e tyre dhe sistemet e komponentëve dhe njësitë e këmbyeshme të parashikuar për këto mjete", prodhuar përpara datës 15 korrik 2019, ose deri në vitin 2036 apo deri në përfundim të kohëzgjatjes së shërbimit të këtyre mjeteve motorike, cilado datë që vjen e para;<br>4. Përjashtimet specifike për pjesët e këmbimit të mjeteve motorike referuar në pikën 3(b)(ii) me sipër, zbatohen për prodhimin dhe përdorimin e decaBDE, që përkon me një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme:<br>a) sistem transmisioni dhe lidhje nën kofanon e mjetit, siç janë përcjellësit e baterisë, kabllot ndërlidhëse të baterisë, tubat e lëvizshëm të ajrit të kondicionuar (MAC), sistemet e transmisionit, unazat e tubave të shkarkimit, izolimi nën kofano, lidhjet elektrike dhe rripat nën kofano (lidhjet elektrike në motor etj.), sensorët e shpejtësisë, zorra, njësi ventilimi dhe sensorët e trokitjes;<br>b) aplikimet në sistemin e karburantit, siç janë tubat, serbatorët dhe serbatorët e karburantit nën trupin e mjetit;<br>c) pajisje piroteknike dhe aplikime të ndikuara nga pajisje piroteknike, siç janë jastëku i ajrit, kabllot e ndezjes, mbulesat/veshjet e ndenjëseve (vetëm nëse janë të përshtatshme për jastëkun e ajrit) dhe jastëkët e ajrit (të përparmë dhe të pasmë). |
| | | | | | 5. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të cilat kanë decaBDE në përbërje.<br>6. Pa cenuar zbatimin e parashikimeve të tjera të legjislacioneve që rregullojnë klasifikimin, etiketimin dhe ambalazhimin e kimikateve, artikujt në të cilët përdoren decaBDE do të identifikohen nëpërmjet etiketimit ose mënyrave të tjera gjatë ciklit të tyre të jetës.<br>7. Lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve që përmbajnë decaBDE, të importuar për qëllime të përjashtimeve specifike në pikën 3, me sipër, deri në datën e mbarimit të përjashtimit. Pika 6, zbatohet sikur këta artikuj të ishin prodhuar në përputhje me përjashtimin në pikën 3. Artikuj të tillë që janë në përdorim deri në datën e mbarimit të përjashtimit përkatës mund të vazhdojnë të përdoren.<br>8. Për qëllime të kësaj hyrjeje, "mjet ajror" nënkupton si më poshtë:<br>a) mjet ajror civil i prodhuar në përputhje me certifikatën e tipit të lëshuar sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për transportin nr. 3, datë 7.2.2011, "Për rregullat e përbashkëta në fushën e Aviacionit Civil", të ndryshuar, ose me miratimin e projektimit të lëshuar sipas rregulloreve kombëtare të një shteti nënkontraktues të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil ((ICAO), ose për të cilin është lëshuar një certifikatë e vlefshmërisë ajrore nga një Shtet Kontraktues i ICAO-s, sipas aneksit 8 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar;<br>b) mjet ajror ushtarak. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Acidi sulfonik i perfluorooktanit dhe derivatët e vet (PFOS)<br>*(Perfluorooctane sulfonic acid and its derivatives (PFOS)*<br>$C_8F_{17}SO_2X$<br>(X = OH, kripëra metalike (O-M+), halide, amide, dhe derivate të tjera, duke përfshirë polimeret) | 1763-23-1<br>2795-39-3<br>29457-72-5<br>29081-56-9<br>70225-14-8<br>56773-42-3<br>251099-16-8<br>4151-50-2<br>31506-32-8<br>1691-99-2<br>24448-09-7<br>307-35-7 dhe të tjera | 2909 30 38<br>2904 34 00<br>2904 32 00<br>2922 16 00<br>2923 30 00 | 217-179-8<br>220-527-1<br>249-644-6<br>249-415-0<br>274-460-8<br>260-375-3<br>223-980-3<br>250-665-8<br>216-887-4<br>246-262-1<br>206-200-6<br>dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e PFOS-së, që janë të barabarta me ose nën 10 mg/kg (0,001 % të peshës), kur ndodhet në substanca ose në përzierje.<br>2. Për qëllime të kësaj hyrjeje, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e PFOS-së në produkte ose artikuj gjysmë të gatshëm, ose pjesë të tyre, nëse përqendrimi i PFOS-së është më i ulët sesa 0,1% e peshës së përllogaritur, duke marrë si referencë masën e pjesëve të veçanta të strukturuara ose mikro të strukturuara që përmbajnë PFOS, ose për tekstile apo materiale të veshura, nëse sasia e PFOS është më e ulët se sa 1 μg/m$^2$ e materialit të veshur.<br>3. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës 1 korrik 2015, të cilat kanë PFOS në përbërje.<br>4. Nëse sasia e çliruar në mjedis është zvogëluar, prodhimi dhe vendosja në treg lejohet deri më 7 shtator 2025, për t'u përdorur për kontrollin e avullit nga veshjet me krom të ashpër jodekorativ (VI) në sistemet me qark të mbyllur.<br>Kur një përjashtim i tillë përben shqetësim për prodhimin ose përdorimin në një instalim industrial që rregullohet sipas ligjit nr. 10488, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, zbatohen teknikat përkatëse më të mira në dispozicion për parandalimin dhe minimizimin e shkarkimeve të PFOS-së, në përputhje me atë legjislacion.<br>5. Standardet e miratuara nga Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN), dhe/ose me Standardet Shqiptare (SSH), që janë adoptime të Standardeve Evropiane (EN), të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), përdoren si metoda analitike testimi për të treguar përputhshmërinë e substancave, përzierjeve dhe artikujve të pikave 1 dhe 2. Çdo metodë tjetër analitike për të cilën përdoruesi mund të tregojë performancë ekuivalente mund të përdoret si alternativë për standardet CEN dhe/ose SSH. |
| 7 | DDT<br>(1,1,1-trikloro-2,2-bis(4-klorofenol) etani)<br>*((1,1,1-trichloro-2,2-bis(4-chlorophenyl)ethane))* | 50-29-3 | 2903 92 00 | 200-024-3 | — |
| 8 | Klordan<br>*(Chlordane)* | 57-74-9 | 2903 82 00 | 200-349-0 | — |
| 9 | Hekzaklorcikloheksani, përfshirë lindanin<br>*(Hexachlorocyclohexanes, including lindane)* | 58-89-9 | 2903 81 00 | 200-401-2 | |
| | | 319-84-6 | | 206-270-8 | |
| | | 319-85-7 | | 206-271-3 | |
| | | 608-73-1 | | 210-168-9 | |
| 10 | Dieldrin | 60-57-1 | 2910 40 00 | 200-484-5 | — |
| 11 | Endrin | 72-20-8 | 2910 90 00 | 200-775-7 | — |
| 12 | Heptaklor<br>*(Heptachlor)* | 76-44-8 | 2903 82 00 | 200-962-3 | — |
| 13 | Endosulfan | 115-29-7<br>959-98-8<br>33213-65-9 | 2920 30 00 | 204-079-4 | Lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve që janë në përdorim përpara ose deri në datën 1 korrik 2015, që përmbajnë endosulfan. |
| 14 | Hekzaklorobenzeni<br>*(Hexachlorobenzene)* | 118-74-1 | 2903 92 00 | 204-273-9 | — |
| 15 | Klordekoni<br>*(Chlordecone)* | 143-50-0 | | 205-601-3 | — |
| 16 | Aldrin | 309-00-2 | 2903 82 00 | 206-215-8 | — |
| 17 | Pentaklorobenzeni<br>*(Pentachlorobenzene)* | 608-93-5 | 2903 82 00 | 210-172-0 | — |
| 18 | Bifenile të Poliklorinuara<br>*(Polychlorinated Biphenyls)*<br>(PCB) | 1336-36-3<br>dhe të tjera | `2903 92 00 | 215-648-1<br>dhe të tjera | Lejohet përdorimi i artikujve që janë në përdorim në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pa rënë ndesh me VKM-në nr. 387, datë 6.5.2015, "Për miratimin e rregullave për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve të përdorura". |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Institucionet përgjegjëse identifikojnë dhe heqin nga përdorimi pajisje (p.sh., transformatorë, kondensatorë ose enë që mbajnë stoqe lëngjesh) që përmbajnë më shumë se sa 0,005% PCB dhe vëllime më të mëdha sesa 0,05 $dm^3$, sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2025. |
| 19 | Mireks<br>*(Mirex)* | 2385-85-5 | | 219-196-6 | — |
| 20 | Toksafen<br>*(Toxaphen)* | 8001-35-2 | | 232-283-3 | — |
| 21 | Hekzabromobifenil<br>*(Hexabromobiphenyl)* | 36355-01-8 | 2903 99 90 | 252-994-2 | — |
| 22 | Hekzabromociklododekani<br>*(Hexabromocyclododecane)*<br>"Hekzabromociklododekani" do të thotë:<br><br>hekzabromociklododekan 1,2,5,6,9,10-hexab romociklododekani dhe diastereomeret e tij kryesore: alfa-hekzabromociklo dodekani; beta-hekzabromociklo dodekani; dhe gama-hekzabromo ciklododekani | 25637-99-4,<br>3194-55-6,<br>134237-50-6,<br>134237-51-7,<br>134237-52-8 | 2903 89 80<br>3824 99 92 | 247-148-4,<br>221-695-9 | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrime të hekzabromociklododekanit të barabarta me ose nën 100 mg/kg (0,01 % të peshës) kur ndodhet në substanca, përzierje, artikuj ose në përbërje të artikujve rezistentë ndaj flakës.<br>2. Artikujt prej polistireni të zgjeruar që përmbajnë hekzabromociklododekan, që janë tashmë në përdorim në ndërtesa përpara datës 21 shkurt 2018, dhe artikujt prej polistireni të ekstruduar që përmbajnë hekzabromociklododekan tashmë në përdorim në ndërtesa përpara datës 23 korrik 2016, mund të vazhdojnë të përdoren.<br>3. Pa cenuar zbatimin e dispozitave të tjera të legjislacionit për klasifikimin, paketimin dhe etiketimin e kimikateve, polistireni i zgjeruar i vendosur në treg pas datës 23 mars 2016, në të cilin është përdorur hekzabromociklododekan, identifikohet nëpërmjet etiketimit ose mënyrave të tjera gjatë ciklit të tyre të jetës. |
| 23 | Hekzaklorobu-tadieni<br>*(Hexachlorobutadiene)* | 87-68-3 | Për t'u përcaktuar sipas NKM | 201-765-5 | Lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve që janë në përdorim përpara ose deri me 1 korrik 2015, që përmbajnë hekzaklorobutadien. |
| 24 | Pentaklorofenoli dhe kripërat dhe esteret e tij<br>*(Pentachlorophenol and its salts and esters)* | 87-86-5<br>dhe të tjera | 2903 29 00 | 201-778-6<br>dhe të tjera | Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e pentaklorofenolit dhe të kripërave dhe estereve të tij, që janë të barabarta me ose nën 5 mg/kg (0,0005 % të peshës), kur ndodhen në substanca, përzierje ose artikuj. |
| 25 | Naftalene të Poliklorinuara<br>(*Polychlorinated naphthalenes*) (⁷) | 70776-03-3<br>dhe të tjera | | 274-864-4<br>dhe të tjera | Lejohet vendosja në treg dhe përdorimi i artikujve që janë në përdorim përpara ose deri me 1 korrik 2015, që përmbajnë naftalene të poliklorinuara. |
| 26 | Alkanet $C_{10}$-$C_{13}$, kloro parafinat e klorinuara (parafina të klorinuara me zinxhir të shkurtër) (SCCP)<br><br>*(Alkanes $C_{10}$-$C_{13}$, chloro (short-chain chlorinated paraffins) (SCCPs))* | 85535-84-8<br>dhe të tjera | 3824 90 97 | 287-476-5 | 1. Si përjashtim, lejohet prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i substancave ose përzierjeve që përmbajnë SCCP në përqendrime më të ulëta se sa 1% të peshës, ose artikuj që përmbajnë SCCP në përqendrime më të ulëta sesa 0,15% të peshës.<br>2. Lejohet përdorimi, për:<br>a) Shiritat transportues në industrinë minerare dhe izolues për diga, që përmbajnë SCCP tashmë në përdorim përpara ose deri në datën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi; dhe<br>b) artikuj që përmbajnë SCCP, të ndryshëm nga ata të përmendur në germën "a", tashmë në përdorim përpara ose deri më 1 korrik 2015. |
| 27 | Acidi perfluorooktanoik (PFOA), kripërat e tij dhe komponimet lidhur me PFOA<br>*(Perfluorooctanoic acid (PFOA), its salts and PFOA-related compounds)*<br><br>"Acidi perfluorooktanik (PFOA), kripërat e tij dhe komponimet lidhur me PFOA" nënkuptojnë si më poshtë:<br>i. acid perfluorooktanik, duke përfshirë polimeret e tij | 335-67-1<br>dhe të tjera | Për t'u përcaktuar sipas NKM | 206-397-9<br>dhe të tjera | 1. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e PFOA ose të kripërave të saj, që janë të barabarta me ose nën 0,025 mg/kg (0,0000025% të peshës), kur ndodhen në substanca, përzierje ose artikuj.<br>2. Për qëllime të kësaj hyrjeje, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e komponimeve individuale lidhur me PFOA ose të kombinimeve të komponimeve lidhur me PFOA, që janë të barabarta me ose nën 1 mg/kg (0,0001% të peshës), kur ndodhen në substanca, përzierje ose artikuj.<br>3. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e komponimeve |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | ii. kripërat e tij;<br>iii. komponime të lidhura me PFOA, të cilat, për qëllime të Konventës, janë substanca që shpërbëhen në PFOA,<br>duke përfshirë çdo substancë (përfshi kripërat dhe polimeret) që ka një grup linear ose të degëzuar perfluoroheptil me formulë $(C_7F_{15})C$ e lidhur direkt me një atom tjetër të karbonit, si një nga elementët strukturorë.<br>Komponimet e mëposhtme nuk përfshihen si komponime të lidhura me PFOA:<br>i. $C_8F_{17}$-X,<br>ku X = F, Cl, Br;<br>ii. fluoropolimeret që përfshihen nga $CF_3[CF_2]$n-R',<br>ku R'=çdo grup, n> 16;<br>iii. acide karboksilike perfluoroalkil (duke përfshirë kripërat, esteret, halidet dhe anhidridet e tyre) me ≥ 8 karbone të perfluorinuara;<br>iv. acide sulfonike perfluoroalkane dhe acide perfluoro-fosforike (duke përfshirë kripërat, esteret, halidet dhe anhidridet e tyre) me ≥ 9 karbone të perfluorinuara;<br>v. acidi sulfonik i perfluorooktaneve dhe derivatet e tij (PFOS), siç renditet në këtë aneks. | | | | lidhur me PFOA, që janë të barabarta me ose nën 20 mg/kg (0,002% të peshës), kur ndodhen në një substancë që përdoret si Ndërmjetës i izoluar i transportuar sipas kuptimit të pikës 1.28(iii), neni 5, kreu I, i ligjit 27/2016, "Për menaxhimin e kimikateve", dhe duke përmbushur në mënyrë strikte kushtet e kontrolluara të përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi për prodhimin e fluorokimikateve me anë të zinxhirit të perfluorokarbonit të barabartë me ose më të shkurtër sesa 6 atome.<br>4. Për qëllime të hyrjes së kësaj substance, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e PFOA dhe kripërave të saj të barabarta me ose nën 1mg/kg (0,0001 % e peshës), kur ato janë të pranishme në mikropudër politetrafluoroetileni (PTFE), prodhuar nëpërmjet rrezatimit jonizues ose shpërbërjes termike, si dhe në përzierje dhe artikuj për përdorime industriale dhe profesionale, që përmbajnë mikropudër PTFE. Të gjitha shkarkimet e PFOA-së gjatë prodhimit dhe përdorimit të mikropudrës PTFE duhet të shmangen dhe, nëse është e mundur, të reduktohen sa më shumë që të jetë e mundur.<br>5. Si përjashtim, lejohet prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i PFOA-së, kripërave të saj dhe komponimeve lidhur me PFOA për qëllimet e mëposhtme:<br>a) në proceset fotolitografike ose në proceset zinkografike në prodhimin e gjysmëpërçuesit, deri më 4 korrik 2025;<br>b) në veshjet fotografike që aplikohen në filma, deri më 4 korrik 2025;<br>c) tekstile të papërshkueshme nga vaji dhe uji për mbrojtjen e punëtorëve nga lëngjet e rrezikshme që përbëjnë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e tyre, deri më 4 korrik 2023;<br>d) pajisje mjekësore invazive dhe të implantueshme, deri më 4 korrik 2025;<br>e) prodhimi i politetrafluoroetilenit (PTFE) dhe fluorid polivinilidenit (PVDF) për prodhimin e:<br>i. membranave të filtrit të gazit rezistente ndaj korrozionit dhe me performancë të lartë, membranave të filtrit të ujit dhe membranave për tekstilet mjekësore;<br>ii. pajisjeve të shkëmbimit të nxehtësisë për mbetjet industriale,<br>iii. izoluesve industrialë që parandalojnë rrjedhjen e komponimeve organike të paqëndrueshme dhe të grimcave PM2.5;<br>deri më 4 korrik 2023. |
| | | | | | 6. Si përjashtim, lejohet përdorimi i PFOA-së, kripërave të saj dhe komponimeve lidhur me PFOA-në në shkumat kundër zjarrit për fikjen e avujve të karburantit të lëngshëm dhe të zjarrit nga karburanti i lëngshëm (zjarre të klasës B), tashmë të instaluar në sisteme, duke përfshirë si sistemet e lëvizshme ashtu dhe ato fikse, deri më 4 korrik 2025, sipas kushteve të mëposhtme:<br>a) shkuma kundër zjarrit që përmban ose mund të përmbajë PFOA, kripërat e saj dhe/ose komponime lidhur me PFOA nuk përdoret për trajnime;<br>b) shkuma kundër zjarrit që përmban ose mund të përmbajë PFOA, kripërat e saj dhe/ose komponime lidhur me PFOA nuk përdoret për testime përveçse nëse kufizohen të gjitha çlirimet;<br>c) që nga 1 janari 2023, përdorimet e shkumës kundër zjarrit që përmban ose mund të përmbajë PFOA, kripërat e saj dhe/ose komponime lidhur me PFOA lejohen vetëm në zona ku kufizohen të gjitha çlirimet;<br>d) stoqet e shkumave kundër zjarrit që përmbajnë ose mund të përmbajnë PFOA, kripërat e saj dhe/ose komponime lidhur me PFOA, menaxhohen në përputhje me seksionin I, kreu III, i vendimit 360/2015.<br>7. Si përjashtim, lejohet përdorimi i bromidit perfluoroktil (*perfluooroctyl bromide*), që përmban jodur perfluoroktil (*perfluoroctyl iodide*) për qëllime të prodhimit |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | të produkteve farmaceutike.<br>8. Lejohet përdorimi i artikujve, që janë në përdorim në vend, përpara datës së zbatimit të këtij vendimi, të cilat kanë PFOA, kripërat e saj dhe/ose komponime lidhur me PFOA-në në përbërje.<br>9. Si përjashtim, lejohet prodhimi, vendosja në treg dhe përdorimi i PFOA-së, kripërave të saj dhe komponimeve lidhur me PFOA deri në datën e fillimit të zbatimit të këtij vendimi, për qëllimet e mëposhtme:<br>a) pajisje mjekësore, të ndryshme nga ato të implantueshme, që janë objekt i legjislacionit për pajisjet mjekësore;<br>b) bojëra printimi lateks;<br>c) nanoveshjet e plazmës.<br>10. Për qëllime të kësaj hyrje, shkronja "b", e pikës 1, të seksionit 2, të kreut II, të vendimit 360/2015, zbatohet për përqendrimet e PFOA dhe kripërave të saj, dhe/ose komponimeve lidhur me PFOA, që janë të barabarta me ose nën 2 mg/kg (0,0002% të peshës), kur ndodhen në pajisje mjekësore të ndryshme nga pajisjet invazive dhe ato implantuese. |
| 28 | Dikofoli<br>*(Dicofol)* | 115-32-2 | 2906 29 00 | 204-082-0 | Asnjë. |

## PJESA B
## SUBSTANCAT E LISTUARA VETËM NË PROTOKOLL

| Emri i substancës | Nr. CAS | Nr. KE | Përjashtime specifike për përdorim të ndërmjetëm ose specifikime të tjera |
|---|---|---|---|
| | | | |

## ANEKSI II
## LISTA E SUBSTANCAVE SUBJEKT I MASAVE PËR REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE

## PJESA A

Substanca (Nr. CAS)
- Dibenzo-p-dioksinat dhe Dibenzofuranet e Poliklorinuara (PCDD/PCDF)
- Bifenilet e Poliklorinuara (PCB)

## PJESA B

**Substanca (nr. CAS)**
- Hekzaklorobenzeni (HCB) (NR. CAS 118-74-1)
- Hidrokarburet Policiklike Aromatike (PAH) ([1])
- Pentaklorobenzeni (Nr. CAS 608-93-5)
- Hekzaklorobutadieni (Nr. CAS 87-68-3)
- Naftalene të Poliklorinuara (Nr. CAS 70776-03-3 dhe të tjera)

([1]) Për qëllime të "*Inventarëve të shkarkimeve*", duhet të përdoren 4 (katër) treguesit e mëposhtëm: benzo(a)pireni, benzo(b) fluoranteni, benzo(k)fluoranteni dhe indeno (1,2,3-cd)pireni.

# ANEKSI III
# LISTA E SUBSTANCAVE SUBJEKT I DISPOZITAVE TË MENAXHIMIT TË MBETJEVE TË PËRCAKTUARA NË SEKSIONIN 2, TË KREUT III, TË VKM-së 360/2015

| Nr. rendor | Emri i substancës | Nr. CAS | Nr. KE | Limiti i përqendrimit referuar pikes **2.4/a, të kreut III, të VKM 360/2015,** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Endosulfan | 115-29-7<br>959-98-8<br>33213-65-9 | 204-079-4 | 50 mg/kg |
| 2 | Hekzaklorobutadieni | 87-68-3 | 201-765-5 | 100 mg/kg |
| 3 | Naftalene të Poliklorinuara (1) | | | 10 mg/kg |
| 4 | Alkanet $C_{10}$-$C_{13}$, kloro parafinat e klorinuara (parafina të klorinuara me zinxhir të shkurtër) (SCCP) | 85535-84-8 | 287-476-5 | 10 000 mg/kg |
| 5 | Eteri i Tetrabromodifenilit $C_{12}H_6Br_4O$ | 40088-47-9 dhe të tjera | 254-787-2 dhe të tjera | Shuma e përqendrimeve të eterit të tetrabromodifenilit, eterit të pentabromodifenilit, eterit të hakzabromodifenilit, eterit të heptabromodifenilit dhe eterit të dekabromodifenilit: 1 000 mg/kg. |
| 6 | Eteri i pentabromodifenilit $C_{12}H_5Br_5O$ | 32534-81-9 dhe të tjera | 251-084-2 dhe të tjera | |
| 7 | Eteri i hekzabromodifenilit $C_{12}H_4Br_6O$ | 36483-60-0 dhe të tjera | 253-058-6 dhe të tjera | |
| 8 | Eteri i heptabromodifenilit $C_{12}H_3Br_7O$ | 68928-80-3 dhe të tjera | 273-031-2 dhe të tjera | |
| 9 | Eteri i dekabromodifenilit $C_{12}Br_{10}O$ | 1163-19-5 dhe të tjera | 214-604-9 dhe të tjera | |
| 10 | Acidi sulfonik i perfluorooktaneve dhe derivatet e tij (PFOS) $C_8F_{17}SO_2X$<br>(X = OH, kripëra metalike (O-M+), halide, amide, dhe derivate të tjera, duke përfshirë polimeret) | 1763-23-1<br>2795-39-3<br>29457-72-5<br>29081-56-9<br>70225-14-8<br>56773-42-3<br>251099-16-8<br>4151-50-2<br>31506-32-8<br>1691-99-2<br>24448-09-7<br>307-35-7<br>dhe të tjera | 217-179-8<br>220-527-1<br>249-644-6<br>249-415-0<br>274-460-8<br>260-375-3<br>223-980-3<br>250-665-8<br>216-887-4<br>246-262-1<br>206-200-6<br>dhe të tjera | 50 mg/kg |
| 11 | Dibenzo-p-dioksinat dhe Dibenzofuranet e Poliklorinuara (PCDD/PCDF) | | | 15 μg/kg (2) |
| 12 | DDT (1,1,1-trikloro-2,2-bis(4- klorofenol)etani) | 50-29-3 | 200-024-3 | 50 mg/kg |
| 13 | Klordani | 57-74-9 | 200-349-0 | 50 mg/kg |
| | Hekzaklorciklohekzani, përfshirë lindanin | 58-89-9<br>319-84-6<br>319-85-7<br>608-73-1 | 210-168-9<br>200-401-2<br>206-270-8<br>206-271-3 | 50 mg/kg |
| 15 | Dieldrin | 60-57-1 | 200-484-5 | 50 mg/kg |
| 16 | Endrin | 72-20-8 | 200-775-7 | 50 mg/kg |
| 17 | Heptaklor | 76-44-8 | 200-962-3 | 50 mg/kg |
| 18 | Hekzaklorobenzeni | 118-74-1 | 204-273-9 | 50 mg/kg |
| 19 | Klordekoni | 143-50-0 | 205-601-3 | 50 mg/kg |
| 20 | Aldrin | 309-00-2 | 206-215-8 | 50 mg/kg |
| 21 | Pentaklorobenzeni | 608-93-5 | 210-172-0 | 50 mg/kg |
| 22 | Bifenile të Poliklorinuara (PCB) | 1336-36-3 dhe të tjera | 215-648-1 | 50 mg/kg (3) |
| 23 | Mireks | 2385-85-5 | 219-196-6 | 50 mg/kg |
| 24 | Toksafen | 8001-35-2 | 232-283-3 | 50 mg/kg |
| 25 | Hekzabromobifenili | 36355-01-8 | 252-994-2 | 50 mg/kg |
| 26 | Hekzabromociklododekani (4) | 25637-99-4,<br>3194-55-6,<br>134237-50-6,<br>134237-51-7,<br>134237-52-8 | 247-148-4<br>221-695-9 | 1 000 mg/kg |

1) Naftalene të poliklorinuara, nënkupton komponimet kimike që përbëhen nga sistemi unazor i naftalinës, ku një ose më shumë atome hidrogjeni zëvendësohen nga atome klori.

2) Limiti është llogaritur si PCDD dhe PCDF sipas Faktorëve Ekuivalentë Toksikë (FET) të mëposhtëm:

3) Zbatohet metoda e llogaritjes e përcaktuar në standardet evropiane EN 12766-1 dhe EN 12766-2.

4) “Hekzabromociklododekani” do të thotë hekzabromociklododekan, 1,2,5,6,9,10-hekzabromociklododekan dhe diastereomeret e tij kryesore: alfa-hekzabromociklododekan, beta-hekzabromociklododekan dhe gama-hekzabromociklododekan.

| PCDD | FET | | PCDF | FET | | PCDD | FET |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2,3,7,8-TeCDD | 1 | | 2,3,7,8-TeCDF | 0,1 | | 1,2,3,6,7,8-HxCDF | 0,1 |
| 1,2,3,7,8-PeCDD | 1 | | 1,2,3,7,8-PeCDF | 0,03 | | 1,2,3,7,8,9-HxCDF | 0,1 |
| 1,2,3,4,7,8-HxCDD | 0,1 | | 2,3,4,7,8-PeCDF | 0,3 | | 2,3,4,6,7,8-HxCDF | 0,1 |
| 1,2,3,6,7,8-HxCDD | 0,1 | | 1,2,3,4,7,8-HxCDF | 0,1 | | 1,2,3,4,6,7,8-HpCDF | 0,01 |
| 1,2,3,7,8,9-HxCDD | 0,1 | | | | | 1,2,3,4,7,8,9-HpCDF | 0,01 |
| 1,2,3,4,6,7,8-HpCDD | 0,01 | | | | | OCDF | 0,0003 |
| OCDD | 0,0003 | | | | | | |

ANEKSI IV
MENAXHIMI I MBETJEVE

PJESA 1
ASGJËSIMI DHE RIKUPERIMI

Operacionet e mëposhtme të asgjësimit dhe rikuperimit, siç parashikohet në Shtojcat I dhe II, të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, lejohen për qëllime të pikës 2, të seksionit II, të kreut III, të vendimit 360/2015, kur zbatohen në mënyrë të tillë që siguron se përmbajtja e ndotësve organikë të qëndrueshëm është shkatërruar ose është transformuar në mënyrë të pakthyeshme:

| | |
|---|---|
| D9 | Trajtimi fiziko-kimik. |
| D10 | Incenerimi mbi tokë. |
| R1 | Përdorimi kryesisht si lëndë djegëse ose mënyra të tjera për të prodhuar energji, duke përjashtuar mbetjet që përmbajnë PCB |
| R4 | Riciklimi/rigjenerimi i metaleve dhe komponimeve metalike, në kushtet e mëposhtme:<br>Operacionet janë të kufizuara për mbetjet nga proceset e prodhimit të çelikut dhe të hekurit, sikurse janë pluhurat ose llumrat nga trajtimi i gazeve, pluhuri i filtrave me përmbajtje zinku gjatë prodhimit të çelikut, pluhurat nga sistemet e pastrimit të gazit gjatë shkrirjes së bakrit dhe mbetjet e ngjashme, si dhe mbetjet nga rrjedhjet gjatë prodhimeve metalike joferrore që përmbajnë plumb. Përjashtohen mbetjet që përmbajnë PCB.<br>Operacionet janë të kufizuara për proceset për rikuperimin e hekurit dhe lidhjeve të hekurit (furrat elektrike) dhe metaleve joferrore (proceset e furrës rrotulluese Waelz, proceset e shkrirjes në vaska kimike (duke përdorur furrat vertikale ose horizontale), me kusht që impiantet të përmbushin, të paktën, kërkesat minimale për vlerat kufi të shkarkimeve për PCDD dhe PCDF të përcaktuara në përputhje me ligjin nr. 10488, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, pavarësisht nëse proceset janë apo jo subjekt i atij legjislacioni, dhe pa cenuar parashikimet e tjera të tij. |

Operacionet e trajtimit paraprak për shkatërrim ose transformim në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme, në përputhje me këtë pjesë të këtij aneksi, mund të kryhen, duke siguruar se substanca e listuar në aneksin III, të këtij vendimi, që është e izoluar nga mbetjet gjatë trajtimit paraprak, asgjësohet më pas, në përputhje me parashikimet në këtë pjesë të këtij aneksi. Në rastin kur kemi vetëm një pjesë të një produkti apo mbetjeje, të tilla si pajisjet e mbetjeve, që përmbajnë ose janë kontaminuar me ndotës organikë të qëndrueshëm, ato veçohen dhe më pas asgjësohen, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi. Gjithashtu, operacionet e riambalazhimit dhe të ruajtjes së përkohshme mund të zbatohen përpara këtij trajtimi paraprak ose përpara shkatërrimit, apo transformimit përfundimtar, në mënyrë të pakthyeshme, në përputhje me këtë pjesë të këtij aneksi.

PJESA 2
MBETJET DHE OPERACIONET PËR TË CILAT ZBATOHET PIKA 4(b), SEKSIONI II, KREU III

Operacionet e mëposhtme janë të lejueshme për qëllime të pikës 4(b), të seksionit II, të kreut III, të vendimit 360/2015, në përputhje me mbetjet e specifikuara, të përcaktuara nga kodi digjital gjashtëshifror të klasifikuara sipas VKM-së nr. 402, datë 30.6.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".

Operacionet e trajtimit paraprak, mund të zbatohen përpara se të kryhet ruajtja e përhershme, në përputhje me këtë pjesë të këtij Aneksi, duke siguruar se substanca e listuar në aneksin III, që është e izoluar nga mbetjet gjatë trajtimit paraprak, është asgjësuar më pas në përputhje me pjesën 1, të këtij aneksi. Gjithashtu, riambalazhimi dhe operacionet e ruajtjes së përkohshme mund të kryhen përpara këtij trajtimi paraprak ose përpara ruajtjes së përhershme, në përputhje me këtë pjesë të këtij aneksi.

| **Mbetje të klasifikuara sipas VKM-së nr. 402, datë 30.6.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve"** | | **Limitet maksimale të përqendrimit të substancave të listuara në aneksin III (1)** | **Operacionet** |
|---|---|---|---|
| 10 | **MBETJE NGA PROCESE TERMIKE** | Alkanet, $C_{10}$-$C_{13}$ kloro parafinat e klorinuara (parafina të klorinuara me zinxhir të shkurtër) (SCCP): 10 000 mg/kg; | Ruajtja e përhershme lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:<br>1. Ruajtja bëhet në një nga vendet e mëposhtme: |
| 10 01 | Mbetje nga stacionet elektrike dhe impiantet e djegies së brendshme (përveç 19) | Aldrin: 5 000 mg/kg;<br>Klordani: 5 000 mg/kg;<br>Klordekoni: 5 000 mg/kg; | - në formacione të forta shkëmbore, nëntokësore, të thella dhe të sigurta;<br>- në minierat e kripës; |
| 10 01 14 * (2) | Hi nga fundi, skorie dhe pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme, si rezultat i bashkëdjegies | DDT (1,1,1-trikloro-2,2-bis(4- klorofenol)etani): 5 000 mg/kg;<br><br>Dieldrin: 5 000 mg/kg;<br>Endosulfan: 5 000 mg/kg;<br>Endrin: 5 000 mg/kg;<br>Heptaklor: 5 000 mg/kg;<br>Hekzabromobifenili: 5 000 mg/kg;<br><br>Hekzabromociklododekan(3): 1 000 mg/kg;<br><br>Hekzaklorbenzeni: 5 000 mg/kg;<br><br>Hekzaklorobutadieni: 1 000 mg/kg;<br><br>Hekzaklorciklohekzani, përfshirë lindanin: 5 000 mg/kg; | - në lendfille të mbetjeve të rrezikshme, duke siguruar që mbetjet janë ngurtësuar ose janë stabilizuar pjesërisht, aty ku është teknikisht e mundshme, siç kërkohet për klasifikimin e mbetjeve në nënkapitullin 19 03 të VKM-së nr. 402, datë 30.6.2021, "Për miratimin e katalogut të mbetjeve".<br>2. Janë respektuar masat e parashikuara në VKM-në nr. 452, datë 11.7.2002, "Për lendfillet e mbetjeve", i ndryshuar;<br>3. Demonstrohet se masat e përzgjedhura janë të preferueshme nga ana mjedisore. |
| 10 01 16 * | Hi fluturues nga bashkincenerimi, që përmbajnë substanca të rrezikshme | Mireks: 5 000 mg/kg;<br><br>Pentaklorobenzeni: 5 000 mg/kg; | |
| 10 02 | Mbetje nga industria e hekurit dhe e çelikut | Acidi sulfonik i perfluorooktaneve dhe derivatet e tij (PFOS) ($C_8F_{17}SO_2X$)<br>(X = OH, kripëra metalike (O-M+), halide, amide dhe derivate të tjera, duke përfshirë polimeret): 50 mg/kg; | |
| 10 02 07 * | Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve, që përmbajnë substanca të rrezikshme | Bifenile të Poliklorinuara (PCB) (4): 50 mg/kg;<br><br>Dibenzo-p-dioksinat dhe Dibenzofuranet e | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Poliklorinuara: 5 mg/kg; | |
| 10 03 | Mbetje nga metalurgjia termike e aluminit | Naftalene të Poliklorinuara (*): 1 000 mg/kg; | |
| 10 03 04 * | Skrape të prodhimit primar | Shuma e përqendrimeve të eterit të tetrabromodifenilit ($C_{12}H_6Br_4O$), eterit të pentabromodifenilit ($C_{12}H_5Br_5O$), eterit të hakzabromodifenilit ($C_{12}H_4Br_6O$), dhe eterit të heptabromodifenilit ($C_{12}H_3Br_7O$): 10 000 mg/kg; | |
| 10 03 08 * | Zgjyra kripore nga prodhimi dytësor | Toksafen: 5 000 mg/kg | |
| 10 03 09 * | Zgjyra të zeza nga prodhimi dytësor | | |
| 10 03 19 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 10 03 21* | Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur (përfshirë pluhurin e kushinetave të mullirit) që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 10 03 29 * | Mbetje nga trajtimet e zgjyrave të kripës dhe zgjyrave të zeza që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 10 04 | Mbetje nga metalurgjia termike e plumbit | | |
| 10 04 01 * | Zgjyra nga prodhimi primar dhe dytësor | | |
| 10 04 02 * | Shkuma nga prodhimi primar dhe dytësor | | |
| 10 04 04 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve | | |
| 10 04 05 * | Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur | | |
| 10 04 06 * | Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve | | |
| 10 05 | Mbetje nga metalurgjia termike e zinkut | | |
| 10 05 03 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve | | |
| 10 05 05 * | Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve | | |
| 10 06 | Mbetje nga metalurgjia termike e bakrit | | |
| 10 06 03 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve | | |
| 10 06 06 * | Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve | | |
| 10 08 | Mbetje nga metalurgjitë e tjera termike joferrore | | |
| 10 08 08 * | Zgjyrë kripe nga prodhimi primar dhe dytësor | | |
| 10 08 15 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 10 09 | Mbetje nga derdhjet e pjesëve të hekurit | | |
| 10 09 09 * | Pluhur nga oxhakët e gazeve që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 16 | MBETJE TË PASPECIFIKUARA NË LISTË | | |
| 16 11 | Mbetje të veshjeve të brendshme dhe materialeve zjarrduruese | | |
| 16 11 01 * | Mbetje të veshjeve të brendshme me bazë karboni dhe materialeve zjarrduruese nga procese metalurgjike që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 16 11 03 * | Mbetje të tjera të veshjeve të brendshme dhe materialeve zjarrduruese nga procese metalurgjike që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 17 | MBETJE NGA NDËRTIMET DHE PRISHJET (PËRFSHI DHERA TË GËRMUARA NGA ZONA TË KONTAMINUARA) | | |
| 17 01 | Beton, tulla, tjegulla dhe qeramika | | |
| 17 01 06 * | Përzierje të, ose fraksione të ndara betoni, tullash, tjegulla dhe të qeramikës që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 17 05 | Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera) | | |
| 17 05 03 * | Dhera dhe gurë që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 17 09 | Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve | | |
| 17 09 02 * | Mbetje ndërtimi dhe të prishjeve që përmbajnë PCB, duke përjashtuar pajisjet që përmbajnë PCB | | |
| 17 09 03 * | Mbetje të tjera nga ndërtimi dhe të prishjeve (duke përfshirë mbetjet e përziera) që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 19 | MBETJE NGA IMPIANTET E TRAJTIMIT TË MBETJEVE, IMPIANTET E TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA (JO NË | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | VEND) DHE PËRGATITJA E UJIT ME QELLIM PËR PËRDORIM NJERËZOR DHE UJIT NGA PËRDORIMET INDUSTRIALE | | |
| 19 01 | Mbetje nga incenerimi ose piroliza e mbetjeve | | |
| 19 01 07 * | Mbetje të ngurta nga trajtimet e gazeve | | |
| 19 01 11 * | Hirëra fundore dhe llumra që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 19 01 13 * | Hi fluturues që përmban substanca të rrezikshme | | |
| 19 01 15 * | Pluhur kaldajash që përmbajnë substanca të rrezikshme | | |
| 19 04 | Mbetje të qelqëzuara dhe mbetje nga qelqëzimet | | |
| 19 04 02 * | Hi fluturues dhe mbetje të tjera nga trajtimi i gazeve | | |
| 19 04 03 * | Faza të ngurta të paqelqëzuara | | |

1. Këto limite do të zbatohen vetëm në zonat e lendfilleve dhe nuk do të zbatohen në objektet e përkohshme që gjenden nën tokë, për mbetjet e rrezikshme, duke përfshirë minierat e kripës.

2. Çdo mbetje e shënuar me yll (*) konsiderohet mbetje e rrezikshme, sipas legjislacionit përkatës për menaxhimin e integruar të mbetjeve dhe u nënshtrohet parashikimeve të atij legjislacioni.

3. Hekzabromociklododekani' do të thotë hekzabromociklododekan, 1,2,5,6,9,10-hekzabromociklododekan dhe diastereomeret e tij kryesore: alfa-hekzabromociklododekan, beta-hekzabromociklododekan dhe gama-hekzabromociklododekan;

4. Zbatohet metoda e llogaritjes e përcaktuar në standardet evropiane EN 12766-1 dhe EN 12766-2.

Limiti maksimal i përqendrimit të Dibenzo-p-dioksinave dhe Dibenzofuraneve të Poliklorinuara (PCDD dhe PCDF) llogaritet sipas Faktorëve Ekuivalentë Toksikë (FET) të mëposhtëm:

| PCDD | FET |
|---|---|
| 2, 3, 7, 8-TeCDD | 1 |
| 1, 2, 3, 7, 8-PeCDD | 1 |
| 1, 2, 3, 4, 7, 8-HxCDD | 0,1 |
| 1, 2, 3, 6, 7, 8-HxCDD | 0,1 |
| 1, 2, 3, 7, 8, 9-HxCDD | 0,1 |
| 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8-HpCDD | 0,01 |
| OCDD | 0,0003 |
| PCDF | FET |
| 2, 3, 7, 8-TeCDF | 0,1 |
| 1, 2, 3, 7, 8-PeCDF | 0,03 |
| 2, 3, 4, 7, 8-PeCDF | 0,3 |
| 1, 2, 3, 4, 7, 8-HxCDF | 0,1 |
| 1, 2, 3, 6, 7, 8-HxCDF | 0,1 |
| 1, 2, 3, 7, 8, 9-HxCDF | 0,1 |
| 2, 3, 4, 6, 7, 8-HxCDF | 0,1 |
| 1, 2, 3, 4, 6, 7, 8-HpCDF | 0,01 |
| 1, 2, 3, 4, 7, 8, 9-HpCDF | 0,01 |
| OCDF | 0,0003 |

**UDHËZIM**
**Nr. 18, datë 22.6.2022**

**PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE TË BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE VJETORE PËR PUNËSIM**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 7, të nenit 78, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt",

UDHËZOJ:

1. Brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, drejtoria që mbulon politikat e punësimit dhe të aftësimit profesional në ministrinë përgjegjëse për migracionin e punës, të kërkojë dhe mbledhë informacionet dhe të dhënat e poshtëshënuara, nga:

a) Ministria që ka në fushën e përgjegjësisë arsimin, mbi numrin e të diplomuarve që planifikohen të përfundojnë studimet në programet *Bachelor* dhe master për atë vit mësimor (sipas fushave) nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe jopublik;

b) Ministria që ka në fushën e përgjegjësisë çështjet e rendit dhe të sigurisë mbi numrin e lejeve të qëndrimit për motive punësimi (leje unike) lëshuar për vitin paraardhës;

c) Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, për:

- numrin e nxënësve që planifikohet të përfundojnë arsimin profesional sipas Drejtimeve dhe Profileve Mësimore
- statistika mbi punësueshmërinë e shtetasve të huaj që kanë marrë miratim për punësim;
- analizën e nevojave për aftësi në tregun shqiptar të punës;
- informacion mbi nevojat e punëdhënësve për fuqi punëtore të huaj, siguruar nga observatori i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive;
- nevojat për fuqi punëtore të huaj vlerësuar nga përfaqësuesit në Këshillin Konsultativ për Punësimin.

d) Komitetet sektoriale, të dhëna relevante që lidhen me nevojat e tregut të punës për fuqi punëtore të huaj;

e) Si dhe çdo informacion tjetër që institucionet e sipërpërmendura gjykojnë të arsyeshme për përmbushjen e qëllimit të këtij udhëzimi.

2. Në raste të caktuara, drejtoria përgjegjëse për migracionin e punës, u dërgon ministrive /institucioneve kërkesë për informacion që lidhen me tregun e punës.

3. Brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, drejtoria që mbulon politikat e punësimit dhe të aftësimit profesional në ministrinë përgjegjëse për migracionin e punës, bashkëpunon me drejtorinë që mbulon politikat për zhvillimin ekonomik dhe drejtorinë që mbulon çështje të makroekonomisë në ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe financat, si dhe me ministritë e linjës dhe të INSTAT-it për marrjen e informacionit të përpunuar, lidhur me:

a) projeksionet për zhvillimin ekonomik në sektorë të caktuar (investimet e planifikuar sipas sektorëve ekonomikë);

b) fuqinë punëtore të nevojshme për ata sektorë, sipas profesioneve (bazuar në investimet e planifikuar).

4. Drejtoria që mbulon politikat e punësimit dhe të aftësimit profesional në ministrinë përgjegjëse për migracionin e punës, bazuar në informacionin e dërguar nga çdo ministri/institucion, brenda muajit qershor të çdo viti, përgatit një draftraport përmbledhës dhe rekomandime për përcaktimin e kuotave.

5. Drejtoria që mbulon politikat e punësimit dhe të aftësimit profesional në ministrinë përgjegjëse për migracionin e punës, në bashkëpunim me përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, të organizojnë tryeza të përbashkëta me ministritë/institucionet përkatëse, përfaqësues të partnerëve socialë apo ekspertë të ndryshëm, për konsolidimin e draftraportit dhe rekomandimeve për përcaktimin e kuotave vjetore për punësimin e të huajve.

6. Gjetjet nga raporti përmbledhës, rekomandimet dhe përfundimet nga tryezat e përbashkëta, drejtoria që mbulon politikat e punësimit dhe aftësimit profesional në ministrinë përgjegjëse për migracionin e punës, ia paraqet ministrit përgjegjës për çështje të migracionit të punës dhe ministrit përgjegjës të sektorit përkatës, në zbatim të pikës 2, të nenit 78, të ligjit 79/2021, "Për të huajt".

7. Institucionet e përmendura në këtë udhëzim, në zbatim të nenit 78, të ligjit 79/2021, "Për të huajt", bashkëpunojnë për zbatimin e tij.

8. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë të përmendura në këtë udhëzim dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
**Delina Ibrahimaj**

SKEMA OPERACIONALE

I. Mbledhje informacioni (kërkesa, oferta)
II. Përgatitje e draftraportit përmbledhës dhe rekomandimet
III. Takime dhe konsulta me grupet e interesit
IV. Konsolidim i raportit dhe i rekomandimeve bazuar edhe në diskutimet me grupet e interesit
V. Paraqitje e raportit përfundimtar dhe rekomandimeve te ministri përgjegjës për çështjet e migracionit të punës dhe ministri i sektorit përkatës

**UDHËZIM**
**Nr. 19, datë 22.6.2022**

**PËR DEKLARIMIN PËR PUNËSIM**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 80, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt",

UDHËZOJ:

1. Kryerjen e deklarimit për punësim, për shtetasit e huaj të përcaktuar në shkronjën "a" dhe "ç", të nenit 80, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt".

2. Deklarimi për punësim është detyrimi i të huajve për të regjistruar të dhënat e punësimit në *data base*-in e sistemin informatik të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

3. Deklarimi për punësim kryhet në sistemin elektronik *online* nga punëdhënësi ose i huaji i vetëpunësuar apo investitor, brenda 7 (shtatë) ditëve nga fillimi i punës.

4. Dokumentet e nevojshme për kryerjen e deklarimit për punësim janë:

a) Dokument identifikimi;

b) Kontratë pune/vërtetim regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

c) Dokument që vërteton adresën e banimit.

5. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, brenda 4 (katër) ditë pune i kthehet përgjigje shtetasit me komente për plotësim.

6. Konfirmimi për kryerjen e deklarimit për punësim jepet në rrugë elektronike nga sistemi, jo më vonë se 5 (pesë) ditë kalendarike nga momenti i plotësimit të të dhënave dhe i ngarkimit të dokumenteve *online*.

7. Procesi për ruajtjen e të dhënave në sistemin informatik, përfundon jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga momenti i plotësimit *online*.

8. Të dhënat për kryerjen e deklarimit për punësim janë sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi.

9. Në rast të ndryshimit të të dhënave të punësimit të të huajit (adresa e punëdhënësit, kontrata e punës, profesioni ose rajoni), i huaji ose punëdhënësi i tij duhet t'i përditësojë ato.

10. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe strukturat e saj për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
**Delina Ibrahimaj**

ANEKS
DEKLARIMI PËR PUNËSIM

(lutemi plotësoni të dhënat e mëposhtme)

Z./znj. ________________________
Mr./Ms. (Emri Mbiemri/Given name(s) Surname)

Lindur më ______________________
Born on (Data Muaji Viti/Day Month Year)

në ____________________________
in (Vendlindja/Place and country of birth)

me Shtetësi ____________________
Nationality

Me profesion ___________________
Skill qualifications

Lloji i dokumentit dhe numri ________/__/__/__/__/__/__/__/__/__/__/
Type of document and number

Lëshuar më datë _______________,
e cila skadon më _______________
Issued on (Data Muaji Viti/Day Month Year)
Valid until (Data Muaji Viti/Day Month Year)

Me adresë ___________________________
Seat and address

Për të ushtruar aktivitetin/veprimtarinë e tij/saj:
Name of the employer
(Emri i subjektit)

Me adresë: ________________________________
Seat and address

Emri Mbiemri, firma e deklaruesit

__________________

**URDHËR**
**Nr. 178, datë 22.6.2022**

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË LEJES UNIKE SI INVESTITOR**

Në mbështesje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të pikës 13 të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 69, të ligjit 79/2021, "Për të huajt",

URDHËROJ:

1. Krijimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të "Komisionit vlerësues për plotësimin e kritereve të lejes unike si i investitor", quajtur në vijim "Komisioni Vlerësues".

2. Komisioni Vlerësues ka këtë përbërje:
- Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (kryetar);
- Një përfaqësues i Shërbimeve dhe Migracionit (anëtar);
- Një përfaqësues i Qendrës së Formimit Profesional (anëtar).

2.1 Për çdo anëtar caktohet një zëvendësues, i cili zëvendëson anëtarin kryesor në rast pamundësie të përkohshme.

2.2 Përbërja nominale e Komisionit Vlerësues, përfshirë emrat e anëtarëve zëvendësues, miratohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Urdhri përditësohet sipas nevojës, por jo më shumë se një herë në vit.

3. Komisioni i Vlerësimit funksionon në mënyrë të përhershme dhe kryen detyrat e përcaktuara në këtë urdhër.

4. Organizimi dhe koordinimi i punës bëhet nga kryetari i Komisionit Vlerësues.

5. Mbledhja e Komisionit Vlerësues thirret nga dhe sipas rendit të ditës të përcaktuar nga kryetari i Komisionit Vlerësues.

6. Komisioni Vlerësues, bazuar në plan-biznesin e investimit, verifikon plotësimin e këtyre kritereve:

a) vlera e investimit miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e rendit dhe sigurisë publike dhe ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë;

b) raporti i të punësuarve të huaj/shqiptarë të jetë (1:5), raport që ruhet në bordin drejtues dhe organet e tjera drejtuese ose kontrolluese;

c) paga e shtetasve shqiptarë të mos jetë më e vogël sa paga mesatare në Republikën e Shqipërisë për këto poste të vitit pararendës;

d) aktiviteti nuk është me humbje dhe se është kryer regjistrimi dhe shlyerja e detyrimeve në organet tatimore.

7. Kërkesa dhe ngarkimi i dokumentacionit bëhet përmes sistemit elektronik *online* për lejet unike.

8. Dokumentet e nevojshme, sipas pikës 6 të këtij urdhri, duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të vërtetuara nga noteri.

9. Me përfundim të rregullt të aplikimit dhe të ngarkimit të dokumenteve, sistemi konfirmon marrjen e kërkesës.

10. Verifikimi paraprak i dokumenteve *online* bëhet nga specialistët e sektorit të migracionit.

11. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, brenda 4 (katër) ditëve i kthehet përgjigje shtetasit me komente për plotësim.

12. Kur dokumentacioni është i plotë, specialisti i migracionit përgatit dhe paraqet dosjen e aplikantit te kryetari i Komisionit Vlerësues.

13. Komisioni Vlerësues, analizon plotësimin e kushteve të pikës 6 të këtij urdhri dhe plotëson procesverbalin përkatës, duke u shprehur në mënyrë shteruese (A plotësohen kushtet? Po ose Jo).

14. Nëse është e nevojshme, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të kërkojë nga aplikanti edhe dokumente të tjera shtesë.

15. Vlerësimi për plotësimin e kushteve të lejes unike si investitor, kryhet brenda 10 (dhjetë) ditë pune nga marrja e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 6 të këtij urdhri dhe njoftohet *online*.

16. Vlerësimi i komisionit është i vlefshëm për kohëzgjatjen e planifikuar të investimit, por jo më shumë se 2 (dy) vjet, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, kohë që nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është bërë vlerësimi.

17. Në përfundim të procesit, procesverbali së bashku me dosjen e dokumenteve referuese protokollohen.

18. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
**Delina Ibrahimaj**

**URDHËR**
**Nr. 180, datë 22.6.2022**

**PËR NGRITJEN, PËRBËRJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE TË LEJES UNIKE SI I VETËPUNËSUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 13, të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores të Këshillit të Ministrave", si dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 67, të ligjit 79/2021, "Për të huajt",

URDHËROJ:

1. Krijimin pranë çdo drejtorie rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive të "Komisionit vlerësues për plotësimin e kushteve të lejes unike si i vetëpunësuar", quajtur në vijim "Komisioni Vlerësues".

2. Komisioni vlerësues ka këtë përbërje:

- Drejtuesi i drejtorisë rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (kryetar);
- Një përfaqësues i Shërbimeve dhe Migracionit (anëtar);
- Një përfaqësues i Qendrës së Formimit Profesional (anëtar);

2.1 Për çdo anëtar caktohet një zëvendësues, i cili zëvendëson anëtarin kryesor në rast pamundësie të përkohshme.

2.2 Përbërja nominale e Komisionit Vlerësues, përfshirë edhe emrat e anëtarëve zëvendësues, miratohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive me propozim të strukturave rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Urdhri përditësohet sipas nevojës, por jo më shumë se një herë në vit.

3. Komisioni i Vlerësimit funksionon në mënyrë të përhershme dhe kryen detyrat e përcaktuara në këtë urdhër.

4. Organizimi dhe koordinimi i punës bëhet nga kryetari i Komisionit Vlerësues.

5. Mbledhja e Komisionit Vlerësues thirret nga dhe sipas rendit të ditës të përcaktuar nga kryetari i Komisionit Vlerësues.

6. Komisioni Vlerësues shprehet nëse për biznesin/aktivitetin e planifikuar:

- rajoni ka një interes ekonomik;
- pritet që ai të ketë një ndikim pozitiv mbi ekonominë;
- aplikuesi ka një kapital të mjaftueshëm për të realizuar idenë e biznesit.

7. Krahas informacionit në formatin e aplikimit *online*, dokumentacioni që paraqitet pranë Komisionit Vlerësues për të provuar plotësimin e kushteve të pikës 6, të këtij urdhri është:

A. Për të vetëpunësuarit:

1) Projektide për biznesin/aktivitetin (që pasqyron minimalisht elementet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive);

2) Dokument që provon se ka mjete të mjaftueshme financiare, jo më pak se 500.000 (pesëqind mijë) lekë ose vlera ekuivalente me të në dollarë ose euro (vërtetim nga banka në Republikën e Shqipërisë ose në vendin e origjinës);

3) Dokument që provon aftësitë e nevojshme (certifikatë/diplomë ose dokument të baras vlershëm me të);

4) Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

B. Për profesionistët e lirë:

1) Projektide për biznesin/aktivitetin (që pasqyron minimalisht elementet e rekomanduara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive);

2) Dokument që provon mundësitë financiare, jo më pak se 12 paga miminale mujore, sipas legjislacionit në fuqi (vërtetim nga banka);

3) Licenca për ushtrimin e profesionit (diploma, dokumentacioni sipas legjislacionit për profesionet e rregulluara);

4) Për profesionet e parregulluara (diplomë);

5) Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

8. Kërkesa dhe ngarkimi i dokumentacionit bëhet përmes sistemit elektronik *online* për lejet unike.

9. Dokumentet sipas përcaktimeve në pikën 7.A.2.3 dhe 7.B.2.3.4, duhet të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe dhe të vërtetuara nga noteri.

10. Me përfundim të rregullt të aplikimit dhe ngarkimit të dokumenteve, sistemi konfirmon marrjen e kërkesës.

11. Verifikimi paraprak i dokumentacionit *online* bëhet nga specialistët e migracionit pranë Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

12. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, brenda 4 (katër) ditëve i kthehet përgjigje shtetasit me komente për plotësim.

13. Kur dokumentacioni është i plotë, specialisti i migracionit përgatit dhe paraqet dosjen e aplikantit te kryetari i Komisionit Vlerësues.

14. Komisioni e bazon vlerësimin, në:

a) të dhënat e pasqyruara në formatin e aplikimit *online* në portalin *e-Albania*;

b) zbatueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e idesë së biznesit mbi të cilin bazohet aplikimi;

c) eksperiencën sipërmarrëse të aplikuesit;

d) vlerën e kapitalit që investohet.

15. Komisioni Vlerësues, analizon plotësimin e kushteve të pikës 6 të këtij urdhri dhe plotëson procesverbalin përkatës, duke u shprehur në mënyrë shteruese (A plotësohen kushtet? Po ose Jo);

16. Vlerësimi për plotësimin e kushteve të lejes unike si i vetëpunësuar kryhet brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga marrja e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 7 të këtij urdhri dhe njoftohet *online*.

17. Vlerësimi i komisionit është i vlefshëm për kohëzgjatjen e planifikuar të biznesit, por jo më shumë se 3 (tre) vjet, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, sa kohë që nuk kanë ndryshuar kushtet për të cilat është bërë vlerësimi.

18. Procesverbali së bashku me dosjen e dokumenteve vlerësuese të aplikimit proto-kollohen. Ato janë subjekt i monitorimit të strukturave të Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive.

19. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive dhe strukturat e saj për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
**Delina Ibrahimaj**

## URDHËR
## Nr. 479, datë 24.10.2022

## PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 249, DATË 11.6.2021, "PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E POLONISË, SLLOVAKISË, HUNGARISË, GJERMANISË, UKRAINËS, ÇEKISË, RUMANISË, BULLGARISË, BELGJIKËS, KROACISË, DANIMARKËS, FRANCËS, HOLANDËS DHE ITALISË"

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 249, datë 11.6.2021, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë, Sllovakisë, Hungarisë, Gjermanisë, Ukrainës, Çekisë, Rumanisë, Bullgarisë, Belgjikës, Kroacisë, Danimarkës, Francës, Holandës dhe Italisë".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Frida Krifca**

**URDHËR**
**Nr. 480, datë 24.10.2022**

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve,
e) nënproduktet e shpendëve.

Nga shteti i Rumanisë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 | Bashkia/fshat/provincë |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Giurgiu | Oinacu | - | BRANISTEA |
| 2 | Ialomița | Tandarei | - | TANDAREI |
| 3 | Harghita | Cristuru Secuiesc | - | CRISTURU SECUIESC |
| 4 | Mureș | Grebenisu De Campie | - | GREBENISU DE CAMPIE |
| 5 | Mureș | Cozma | - | COZMA |
| 6 | Mureș | Ungheni | - | Ungheni |

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Frida Krifca**

**URDHËR**
**Nr. 481, datë 24.10.2022**

## PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË REPUBLIKËN E ÇEKISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve;
e) nënproduktet e shpendëve.
Nga Republika e Çekisë sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Vendi /shteti | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja administrative e nivelit 2 | Ndarja administrative e nivelit 3 | Bashkia/fshat/provincë |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Republika e Çekisë | Jihomoravský | Hodonín | - | Hovorany |
| 2 | Republika e Çekisë | Ústecký | Litoměřice | - | Libotenice |
| 3 | Republika e Çekisë | Jihočeský | České Budějovice | - | Údolí |
| 4 | Republika e Çekisë | Jihočeský | České Budějovice | - | Bynov |
| 5 | Republika e Çekisë | Královéhradecký | Hradec Králové | - | Nové Mesto nad Cidlinou |
| 6 | Republika e Çekisë | Středočeský | Beroun | - | Hodyně u Skuhrova |
| 7 | Republika e Çekisë | Královéhradecký | Hradec Králové | - | Klamoš |
| 8 | Republika e Çekisë | Královéhradecký | Hradec Králové | - | Nové Město nad Cidlinou |
| 9 | Republika e Çekisë | Jihočeský | Strakonice | - | Hajany |
| 10 | Republika e Çekisë | Jihomoravský | Hodonín | - | Hovorany |
| 11 | Republika e Çekisë | Středočeský | Příbram | | Trhové Dušníky |

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
4. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
**Frida Krifca**

**URDHËR**
**Nr. 482, datë 24.10.2022**

## PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E FRANCËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve;
e) nënproduktet e shpendëve.
Nga shteti i Francës sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Ndarja administrative e nivelit 1 | Ndarja Administrative e Nivelit 2 | Ndarja Administrative e Nivelit 3 |
|---|---|---|---|
| 1. | Nouvelle-Aquitaine | Deux-Sèvres | Parthenay |
| 2. | Pays de la Loire | Maine-et-Loire | Cholet |
| 3. | Pays de la Loire | Maine-et-Loire | Saumur |
| 4. | Pays de la Loire | Maine-et-Loire | Segre |
| 5. | Pays de la Loire | Vendée | Fontenay-le-Comte |
| 6. | Pays de la Loire | Maine-et-Loire | Angers |
| 7. | Nouvelle-Aquitaine | Dordogne | Périgueux |
| 8. | Nouvelle-Aquitaine | Dordogne | Bergerac |
| 9. | Pays de la Loire | Vendée | La Roche-sur-Yon |
| 10. | Nouvelle-Aquitaine | Dordogne | Sarlat-la-Canéda |
| 11. | Pays de la Loire | Loire-Atlantique | Nantes |
| 12. | Pays de la Loire | Loire-Atlantique | Ancenis |
| 13. | Nouvelle-Aquitaine | Deux-Sèvres | Bressuire |
| 14. | Centre-Val de Loire | Indre-et-Loire | Tours |
| 15. | Normandie | Seine- Maritime | Dieppe |
| 16. | Houts-de-France | Somme | Abbeville |
| 17. | Bretagne | Ille-et-Vilaine | Rennes |
| 18. | Grand Est | Meuse | Commercy |
| 19. | Auvergne-Rhone-Alpes | Ain | Bourg-en-Bresse |
| 20. | Bretagne | Morbihan | Vannes |
| 21. | Hauts-de-France | Somme | Pèronne |
| 22. | Normandie | Manche | Cherbourg |

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

